



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të Danske Commodities A/S nga Equinor Refining Norway AS

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa me Nr. 462 Prot., datë 02.08.2018 “Përqendrimi ndërmjet Equinor Refining Norway AS dhe Danske Commodities A/S ” nga Studio Ligjore Wolf Theiss SHPK, në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar të shoqërisë “Equinor Refining Norway AS”. Përfaqësuesi ligjor ka informuar lidhur me transaksionin që do të rezultojë me marrjen e kontrollit të shoqërisë Danske Commodities A/S nga shoqëria Equinor Refining Norway AS.

Referuar dokumentit “*Marrëveshja e Blerjes së Aksioneve, Projekti Mjelma*” palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Equinor Refining Norway AS, është një shoqëri e themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit norvegjez. Equinor zotërohet tërësisht nga Equinor Group e cila kontrollohet nga Equinor ASA, shoqëria mëmë finale e Equinor Group. Equinor ASA kontrollohet nga Qeveria Norvegjeze nëpërmjet Ministrisë Norvegjeze të Naftës dhe Energjisë.

Equinor Group është aktiv në sektorët e mëposhtëm: (i) explorimi i naftës bruto dhe gazit natyror; (ii) zhvillimi dhe prodhimi i naftës bruto dhe gazit natyror; (iii) marketing dhe përpunimi i naftës bruto dhe gazit natyror; dhe (iv) energjia e rinovueshme, në veçanti energjia e erës.

Equinor Group nuk është i regjistruar, nuk është aktiv dhe nuk ka gjeneruar xhiro në Shqipëri .

Pala shitëse:

Lind Invest ApS; Danske Share ApS dhe Danske Share II ApS, janë shoqëri të themeluara dhe të regjistruara në bazë të ligjeve të Danimarkës. Këto shoqëri kontrollojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shoqërinë **Danske Commodities A/S**

Targeti: Danske Commodities A/S, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit danez. Shoqëria është e specializuar me tregtimin fizik dhe financiar të energjisë elektrike dhe gazit. Danske Commodities bashkon prodhuesit, furnizuesit dhe konsumatorët nëpër tregjet e liberalizura të Europës. Danske Commodities është aktive në marrjen nga origjina dhe siguron balancimin, optimizmin, mbulimin, çertifikatat dhe furnizimin me rezerva për gjeneratorët e energjisë , shoqëritë industruale, furnizuesit dhe operatorët neto.

Danske Commodities A/S operon në Shqipëri nëpërmjet degës së tij Danske Commodities Albania SHPK, me objekt të aktivitetit të saj tregtimin e energjisë elektrike fizike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.